



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

Emërtimi i Modullit: PËRKTHIM TEKNIK NË FUSHËN E TURIZMIT & TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE DHE JOMATERIALE

(sipas KSHK 7, Kualifikim për të nxënit gjatë gjithë jetës 3, Programet e studimeve të formimit të vazhduar)

Programi i Formimit të Vazhduar : “PËRKTHIM TEKNIK, LETRAR DHE INTERPRETIM”

Lloji i Trajnimit: Drejtpërdrejtë dhe online

Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime: “Gjuha e burimit” anglisht, frëngjisht, italisht, të huajisht, greqisht, spanjisht, turqisht, rusisht, shqip.

“Gjuha e synuar” anglisht, frëngjisht, italisht, të huajisht, greqisht, spanjisht, turqisht, rusisht, shqip

Kohëzgjatja e programit të modullit: 30 orë

- 10 orë trajnim i drejtpërdrejtë ose online (3 ditë trajnimi)
- 5 orë studim i literaturës, materialit përkatës
- 15 orë përgatitje individuale për kryerjen e detyrave

Nr. i krediteve: 3 ECTS

Mënyra e zhvillimit:

* Format i kombinuar:

- Sesione teorike: Për të kuptuar terminologjinë specifike, kontekstin kulturor dhe natyror, si dhe standardet e përkthimit në këtë fushë.
- Ushtrime praktike: Për të aplikuar njohuritë e fituara në përkthimin e teksteve reale nga fusha e turizmit dhe trashëgimisë.
- Analiza e studimeve të rasteve: Për të shqyrtuar sfidat dhe zgjidhjet në përkthimin e teksteve të ndryshme (broshura turistike, udhëzues, materiale promovuese, etj.).
- Diskutime dhe feedback: Për të ndarë përvojat, për të diskutuar zgjidhje alternative dhe për të marrë feedback konstruktiv.

* Platformë online:

- Materiale mësimore të disponueshme online (video, artikuj, burime shtesë).
- Forume diskutimi për të ndarë pyetje dhe përvoja.
- Detyra dhe vlerësime online.

REZULTATET E TË NXËNIT:

Programi përmban trajtimin e temave që lidhen me përkthimin në fushën e turizmit dhe sidomos të trashëgimisë natyrore e kulturore për të gjithë ata që punojnë si përkthyes apo si udhërrëfyes turistikë nga gjuha shqipe në gjuhën e huaj dhe anasjelltas. Në trajnim do të trajtohen tekste me terminologji nga fusha në fjalë. Pjesëmarrësit pasi të marrin bazat e përkthimit terminologjik sipas qasjes konjitivo-funksionale në përkthim, do të jenë të aftë të përvetësojnë terminologjinë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

përkatese përmes ushtrimeve dhe përkthimeve konkrete gjatë orëve të trajnimit, por edhe kur të mbarojnë kursin pasi do të pajisen me njohuri teorike dhe metodologjike që do t'i ndihmojë ata të jenë të pavarur në çdo vështirësi përkthimi që mund të hasin në punën e tyre.

OBJEKTIVAT E MODULIT:

1. Të përcillen njohuri për terminologjinë specifike të fushës së turizmit dhe trashëgimisë kulturore e natyrore.
2. Të kuptohet konteksti kulturor dhe natyror i teksteve që do të përkthehen.
3. Të zhvillohen aftësitë kërkimore për të gjetur informacion të saktë dhe të besueshëm.
4. Të zbatohen standardet e përkthimit në këtë fushë, duke përfshirë saktësinë, qartësinë dhe stilin e përshtatshëm.
5. Të krijohen aftësi për të përkthyer tekste të ndryshme nga fusha e turizmit dhe trashëgimisë (broshura, udhëzues, materiale promovuese, etj.).
6. Të zhvillohet vetëdija për rëndësinë e përkthimit të saktë në promovimin e turizmit dhe trashëgimisë.